REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 203/20
Datë/Datum. 24-03-20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendi Komunal i Prizrenit**

Nr. i Prokurimit:	**622-19-9123-2-1-1**
Nr. i brendshëm:	**622-19-217-211**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja e objekteve të Administratës Komunale në Prizren**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"MBB Construction"SH.P.K & ENGRUP SH.P.K. & DAR ING SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.CARALEVES. Nr.81 - Prizren
(Adresa)

Prizren — *20000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

045-145-245 — *810080432*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Kushtrim Bajrami
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

constructionmbb@gmail.com
(Adresa elektronike)

23.03.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

SHOQËRIMI I PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR MBB Construction PRIZREN

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 03.12.2019
Data e hapjes së ofertave: 14.01.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 16.03.2020
Kërkesa për rishqyrtim dt:17.03.2020
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:20.03.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Vendimi i OSHP Nr.88/20 i dt.03.03.2020

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar AK-ja na ka njoftuar me njoftimin mbi vendimin dhe letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm me dt.16.03.2020, ndërsa e ka rekomanduar për kontratë OE "Pro & Co Group SH.P.K.; ARCHI TIME SH.P.K.; N.N.T. A.B.C."
Fillimisht ju sqarojmë se OE që AK-ja e ka rekomanduar për kontratë është shpallur i papërgjegjshëm edhe me vendim të OSHP-së **Nr.88/20 i dt.03.03.2020**, prandaj i njëjti OE nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi dhe AK-ja ka vepruar në kundërshtim me vendimin e një organi më të lartë administrativ.

Ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në FDT sepse tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose master) i licencuar nga AKK, kurse OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë sepse ka ofruar dëshmi për bachelor të gjeodezisë për z. Besnik Loshi, ndërsa ka ofruar një diplomë të masterit të këtij personi, ku shkruan se z. Besnik Loshi ka marrë titullin si master i teknologjisë që në suedisht titullohet Teknologie masterexam, ndërsa kur përkthehet në gjuhën shqipe rezulton se ky titull është Inxhinier i teknologjisë, kurse në diplomë në gjuhën angleze shkruan vetëm Degree of master of science.
Po ashtu edhe në nostrifikimin e diplomës së masterit të këtij personi të dt.27.09.2013 me Nr. 6/4-1614 të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë nuk shkruan se ky person ka fituar gradën Master i Gjeodezisë por shkruan se është vetëm Master i Shkencës dhe nuk shkruan se kjo diplomë përputhet me ndonjë program të gjeodezisë të

universitetit të Prishtinës, prandaj me këto dëshmi kuptohet që nuk është përmbushur kërkesa e AK-së në lidhje me inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose master).

Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë dhe është dashur të shpallet si OE i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë nga ana e AK-së.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka plotësuar kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar minimumi një Damper Volvo, kurse OE i rekomanduar tek lista e mjeteve e ka shënuar se e posedon mjetin e lartpërmendur, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi konkrete për të dëshmuar se e posedon këtë pajisje (DUD, faturë etj.).

Pra pasi që nuk ka ofruar ndonjë dokument edhe pse e ka paraqitur emrin e mjetit në listën e mekanizmit, kjo tregon se OE i rekomanduar nuk e posedon një mjet të tillë dhe nuk e plotëson as këtë kërkesë dhe siç e cekëm dhe më lartë ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm në lidhje me të gjitha këto që u cekën më lartë.
OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar edhe kërkesën në lidhje me punëtorët sepse në listë i ka të shënuar gjithsejtë 19 punëtorë me gjithë stafin profesional, ndërsa është kërkuar 15 punëtorë dhe stafi profesional me 6 inxhinier dhe një person për mbrojtje dhe siguri në punë dhe një person për kontroll të kualitetit në punë.
Ju sqarojmë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit nga ana e autoritetit kontraktues, për faktin se e kanë rekomanduar për kontratë grupin e OE i cili është i papërgjegjshëm, ndërsa në këtë rast është dashur të shpallemi fitues ne, sepse i plotësojmë të gjithë kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Ne me dt. 20.03.020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore.

Në lidhje me arsyen e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim ju sqarojmë se autoriteti kontraktues vetëm i ka përsëritur arsyet e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim ashtu si në herën e parë duke mos e marrë për bazë vendimin e OSHP-së **Nr.88/20 i dt.03.03.2020,** mirëpo tani i referohet edhe vendimit të OSHP-së me Nr.118/18 të dt.10.05.2018, se gjoja është marr për bazë diploma e masterit të inxhinierit Fisnik Loshi, mirëpo në asnjë rast dhe në asnjë fjali në këtë vendim nuk shkruan se z. Fisnik Loshi është master i Gjeodezisë siç është kërkuar në FDT në këtë aktivitet të prokurimit dhe askund nuk i është llogaritur se ka kryer master në Gjeodezi, por në këtë vendim shkruan për përvojën në fushën e rindërtimeve të informacioneve të kadastrit dhe flitet për kompetencat e gjeodeteve të licencuar.
Gjithashtu AK-ja i referohet edhe urdhëresës s OSHP-së nr.281/18 të dt.03.08.2018 për zbatim të vendimit Nr. 118/18 të dt.10.05.2018, mirëpo ju sqarojmë se edhe vetë z. Fisnik Loshi në seancën dëgjimore të dt.16.07.2018 kishte deklaruar se bachelorin e ka në Gjeodezi ndërsa masterin në Land Menagemenet në Suedi. Pra edhe në vendimin dhe urdhëresën q ë thirret AK-ja askund nuk shkruan se z. Fisnik Loshi ka master në Gjeodezi, prandaj referimi i AK-së në këto vendime dhe urdhëresë është i pa bazë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si

operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE "MBB CONSTRUCTION" SH.P.K. & ENGRUP SH.P.K. & DAR ING SH.P.K.**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Gjithashtu kërkojmë që të respektohet vendimi i OSHP-së **Nr.88/20 i dt.03.03.2020.**

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*